



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 73 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, nenit 4, 5 dhe 7 deri 10 të Udhëzimit Administrativ, nr. 01/2016, nenit 28 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 3,4,5 dhe 6 të Rregullores për Komitete Konsultative të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën 31.01.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për

Shpallje të Konkursit publik për zgjedhjen e anëtarëve në Komitete Konsultative në Komunën e Klinës dhe themelimi i Panelit intervistues për përzgjedhjen e anëtarëve të këtyre dy komiteteve

I

Miratohet Vendimi për shpallje të Konkursit publik për zgjedhjen e Komiteteve Konsultative në Komunën e Klinës dhe themelimi i Panelit intervistues.

II

Konkursi si në pikën 1 të këtij Vendimi shpallet për dy Komitete Konsultative në kohë zgjatje prej 15 ditësh :

- 1. Komitetin për Çështje Emergjente dhe**
- 2. Komitetin për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit.**

III

Komitetet Konsultative kanë nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët për punën e tyre kompensohen nga buxheti i Komunës.

Përbërja e Komitetit duhet të kwtw 30% femra.

IV

Mandati i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është 4- vjeçar nga themelimi i Komitetit dhe nuk mund të shërbejnë me shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

V

Kriteret për konkurrim janë:

- 1. Kandidati për anëtar duhet të jetë qytetar komunës së Klinës,**
- 2. Anëtarët e Komiteteve Konsultative janë qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe njohës të fushave përkatëse.**
- 3. Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të jenë anëtarë të Komiteteve Konsultative.**

VI

Kryesuesi dhe zëvendës-kryesuesi zgjidhën me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit Konsultativ.

VII

Komiteti mban së paku 6 takime brenda vitit kalendarik.

VIII

Kuvendi i Komunës themelon **Panelin për zgjedhës**, i cili duhet të ketë në përbërje anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe të shoqërisë civile:

- 1 Saranda Zeqa nga LDK-(KK)
- 2 Xhezide Gashi-Trepça-AAK- (KK)
3. Zeqir Morina- PDK- (KK)
4. Binak Syla- Drejtor i Administratës
5. Tahire Gashi (OJQ)

Paneli intervistues ka për detyrë t'i propozojë Kuvendit listën e ngushtë për anëtarë të Komiteteve Konsultative.

Kushtet, kriteret, mandati dhe afati për anëtarësim dhe procedura e **konkurrimit dhe punës së Panelit intervistues** parashihen në konkurs konform dispozitave ligjore në fuqi dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL), Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, organizimin dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

X

Komuna është e obliguar të ofrojë në dispozicion mjetet e nevojshme në mënyrë që komitetet të kenë mundësi të kryejnë punën e vet në mënyrë efikase.

XI

Pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal të Klinës, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin Mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-631 2018
Klinë, më dt. 06.02 2018



Kryesuesi,
Fadil Gashi